



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

01Nr. 060/01-4294/2026
Kaçanik, 24.02.2026

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **II (dytë)** e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e 8 e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 24.02.2026, në ora 11:00. Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës komunale, në sallën e komiteteve të KK, me fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Komiteti për Politikë dhe Financa- KPF prej 7 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje ishin 7 anëtarët-të gjithë: Selajdin Troni, Lejla Çaka-Muhaxheri, Bashkim Krasniqi, Kadrije Lika-Troni, Ernesta Krasniqi, Ardita Rrahmani, Kjani Zeneli. Nga Ekzekutivi i Komunës, morën pjesë: Kryetari i Komunës- Sabedin Vishi, Drejtorët e Drejtorive: Suad Dullovi-DBPZHR, Arlinda Rakoci -Raka-DZHET, Valdrin Dogani-DBF, Urata Sopa-DAP, Lumnije Demnika- Selmani-DSHMS, Lulzim Krasniqi-DKRS. Korab Krasniqi-DUKMM, Gazmend Bunjaku-DA. Nga zyrtarët: Makfire Malsiu- Zyrtare e Lartë për Punë të KK, Arianitë Bajrami-Asistente e Kryesuesit të KK. Nga OSBE, mbledhjen e monitoroj, Faruk Dërmaku dhe një tjetër.

Mbledhjen e kryesoj, Selajdin Troni, Kryesues i Kuvendit.

Procesmbajtës: Makfire Malsiu, Zyrtare e Lartë për Punë të KK.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit- Selajdin Troni, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, konstatoj kuorumin, prezentë janë 7 anëtarët-të gjithë, materialin e keni marrë, e hapi mbledhjen e II (dytë) të rregullt të KPF-së për vitin 2026, data 24.02.2026.

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Raporti i punës i Ekzekutivit të komunës për vitin 2025;
3. Raporti Vjetor Financiar për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2025;
4. Raporti vjetor i Njësisë së Auditimit të brendshëm, për vitin 2025;
5. Informatë për përfundimin e Gjysmëvjetorit të Parë të vitit shkollor 2025-2026;
6. Propozim Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik Faik (Rufat) Muça;
7. Propozim Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik Isen (Agush) Raka;
8. **Propozim Vendimi për shpallje me interes publik të parcelave kadastrale në Z.K Koxhaj, në Z.K Soponicë dhe Z.K Stagovë (të hiqet);**
9. Propozim Vendimi për shpallje me interes publik të parcelave kadastrale në Z.K në Kaçanik dhe në Z.K Bob;

10. Raporti për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara të reshurat e bores 02.10.2025 dhe të reshurat e shiut 24,25.11.2025:

10.1 Propozim Vendimi për miratimin e Raportit përfundimtar Nr. 25681/2025 dhe Nr. 26224/2025 të datës 14.11.2025 të komisionit komunal mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga reshjet e borës të datës 02.10.2025 në f.Llanishtë dhe f. Stagovë;

10.2 Propozim Vendimi për miratimin e Raportit përfundimtar Nr. 29336/2025 të datës 27.11.2025 të komisionit komunal mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga reshjet e shiut me 24 dhe 15.11.2025 në f. Bob.

Në vazhdim Kryesuesi i Kuvendit, theksoj se pika 8 hiqet nga rendi i punës, ndërsa pika 10 ndahet në 2 nënpikë. Lidhur me rendin e punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendin e punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Prezentë 7. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF,

Aprovoj

Rendin e punës në përbërje si në evidencë, me heqjen e pikës 8 dhe ndarjen pikës 10 në 2 nënpikë.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas renditjes:

1.Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Politikë dhe Financa;

Procesverbali i mbledhjes se kaluar të KPF u aprovua pa vërejtje. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF e,

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes I (parë) të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 27.01.2026/ Lënda: 01Nr.060/01-1776/26.

2. Raporti i punës i Ekzekutivit të komunës për vitin 2025;

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

znj. Kadrije Lika Troni: Të Raporti i ekzekutivit të kutia e ankesave të DAP kam kërkuar edhe me herët që me pasur transparencë, me ardhur një raport me u diskutua me ditur se cila drejtori ka pasur me shumë ankesa, me pa vitet në vijim se a është duke u përmirësuar ajo drejtori, por nuk kemi pranuar kurrfarë raporti në lidhje me këtë çështje.

Kryesuesi i Kuvendit: A ka pasur ankesa?

znj. Kadrije Lika Troni: Është shënuar se është hapur kutia e ankesave. Të gjendja civile të shifra 26520 certifikata të lëshuara, a është vënë në funksion pajisja për nxjerrjen e certifikatave?

znj. Urata Sopa: Pajisja për nxjerrjen e certifikatave e-Kosova është duke funksionuar, certifikatat që nxjerrën aty, kalkuloheh automatikisht dhe bëhen së bashku me ato që nxjerrën fizikisht.

z. Kijani Zeneli: Sa e di unë, me herët nuk ka funksionuar pajisja elektronike.

z. Valdrin Dogani: Jam pak në ngjarje, zyrtari i pasurisë, e ka arkën e vet, e shkarkon dhe i mbledhë bashkë të hyrat dhe i dërgon në bankë.

znj. Ardita Rrahmani: Është fjala për numrin e certifikatave, jo për mjetet që mbledhen.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë Raportin e punës së Ekzekutivit të Komunës e shtroj në votim për aprovim për me aprovim me ia përcjellë Kuvendit të Komunës dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Prezentë 7.

Konstatohet se KPF diskutoj Raportin e punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2025 dhe i njëjti i përcillet Kuvendit të Komunës në procedurë për shqyrtim.

3. Raporti Vjetor Financiar për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2025;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

znj. Kadrije Lika Troni: Të programi i të HVK, të tatimi në pronë, planifikimi ishte 430,752€, realizimi 271,644€, apo për 159,107€ me pak. Arsyeja është kushtëzimi për pagesën e tatimit gjatë regjistrimit të automjeteve, nëse mundem me iu referuar. Kjo për mendimin tim nuk arsyetohet fare, sepse në këtë rast ka dështuar komuna e Kaçanikut në planifikimin e metodave tjera sesi me i mbledhë këto mjete. Kur jemi të të HVK, janë 1 milion 640 mijë e 600 euro në total mjete të shpenzuara, 223 mijë e 881 euro barten për vitin 2026. Me siguri këtu hynë shujtat sipas kontratës kolektive.

Kryetari i Komunës-Sabedin Vishi: Ndoshta është mirë për secilën pyetje, me ia dhënë fjalën drejtorit për përgjigje.

Kryesuesi i Kuvendit: Bënë edhe ashtu.

z. Valdrin Dogani: Ato që po lexoni ju Kadrije, ajo është shuma e shpenzuar e të HVK, Referoju faqes 32 nga 38 të raportit, ku janë paraqitur të HVK të shpenzuara. Bilanci për bartje, janë bartur nga viti 2024 në vitin 2025, 1,033,041.11€. Të pranuar në këtë vit janë, 1,036,330.65€. Totali në dispozicion për ndarje në vitin aktual janë: 2,069,371.76€. prej këtyre fondeve edhe atyre të bartura, janë shpenzuar, 1,640,599.31€. Ndërkaq na mbetin me u bartur në vitin 2026, 428,772.45€.

znj. Kadrije Lika Troni: Të shpenzimet, paga dhe shtesa, janë shpenzuar, 7,357,817.09€, ne suficit janë 9,066.83€ të kthyer në buxhetin e Kosovës. Këtu ju keni theksuar se është si rezultat i rritjes së koeficientit nga Qeveria që buxheti mos me mundur me u planifikuar mirë. Të shpenzimet komunale, janë realizuar 242,698.40€. ndërkaq mosrealizim, 7,705.02€ për shkak të faturimit të vonuar. Të energjia, uji, mbeturinat, të mbeturinat a nuk ka mundur komuna me intervenuar me ardhur me herët faturat, pasi që është aksionare.

z. Valdrin Dogani: Po filloj nga shpenzimet komunale. Fatura e shpenzimit e muajit dhjetor, na vjen në muajin janar të vitit vijues. Ne nuk mundemi me kërkuar me na ardhur fatura në dhjetor. Tjetër, viti fiskal përfundon me 24 dhjetor sipas rregullave për përfundimin e vitit fiskal, ku pagesa nuk mundemi me bërë pas kësaj date, kështu i paraqesim si obligim i komunës për vitin vijues. Të kategoria e pagave, ju të gjithë e dini se buxheti fillestar për këtë kategori 6,557,214.56€. Në fund të dhjetorit qeveria pati vendosur ngritjen e koeficientit për 0.5 për njësi për janar-qershor 2025 dhe 1.0 njësi për korrik-dhjetor 2025 për secilin zyrtar publik. Ato mjete na janë transferuar neve, por të një program buxhetor nuk i ka tërhequr shumë 9,066,83€, të cilat janë në suficit buxhetor. Ju njoftojmë se në vitin 2025, nuk i kemi mbetur askujt borgj për paga.

Ernesta Krasniqi: Sa i përket ekzekutimit të pagave, borgje na keni neve anëtarëve të KK, se nuk i kemi marrë të gjitha kompensimet.

z. Valdrin Dogani: Dua të ju jap një sqarim, është një lëshim teknik, kërkoj falje. Sipas rregullores deri me datën 10 të secilit muaj, obligohet njësia e organizatës buxhetore të përcjellë ndryshimet, pastaj thesari deri me datën 24 të muajit na e përcjellë listën me pa se a janë bërë ndryshimet, ne i shikojmë a janë bërë ndryshimet. Në muajin e kaluar na kanë ardhur me 29 janar, kemi reaguar menjëherë, por pagesat mujore ishin bërë nga thesari, me datën 30 janar 2026, janë ekzekutuar pagat. Tani na kanë ardhur listat e pagave, ato retroaktive që keni pasur me i marrë, nuk realizohen në këtë muaj. E mora një email nga thesari që ato mjete kanë me u ekzekutuar në muajin mars.

znj. Kadrije Lika Troni: Drejtor, fondet e Kryqit të Kuq, në vlerë 2400€ nuk janë shpenzuar. A nuk ka pasur ndonjë projekt, apo çka është në pyetje dhe a barten këto mjete në këtë vit?

z. Valdrin Dogani: Mjetet barten çdo vit, janë grant i përcaktuar i donatorëve. Ne si organizatë buxhetore duhet me bërë një marrëveshje me Kryqin e Kuq, ato mjete me i shpenzuar për ndonjë aktivitet që i përket mallrave e shërbime. Projekt nuk ka pasur. mjete barten në vitin buxhetor. Si suficit nëse mbesin mjete, nuk mundemi me i kthyer në grant qeveritar.

z. Bashkim Krasniqi: Raporti vjetor financiar i përfunduar me 31 dhjetor 2025, është raport i detajuar, kjo të jep me kuptua për transparencë të komunës. Vlen me cekur se GQ është shpenzuar diku 99.9%, kjo tregon për një performancë të mirë, duke iu falenderuar ekzekutivit paraprak. Të HVK të tatimi në pronë, është një disballancë në mes planifikimit dhe realizimit. Ne e dimë se planifikimi asnjëherë nuk mundet me u përputhur me realizimin. Si shkak është cekur, regjistrimit të automjeteve. Unë punoj në atë lëmi, dhe nëse dikush ka dashur me regjistruar automjetin, është dashur me paguar tatimin në pronë, përndryshe nuk ka mundur me regjistruar automjetin. Të ne është dukuri që nëse i kushtëzon njerëzit me diçka, ata reagojnë. Të HVK të cilat barten, unë mendoj se edhe kjo është një sukses, pasi të HVK nuk mund të shpenzohen brenda një viti fiskal. Në përgjithësi unë mendoj se raporti është shumë i suksesshëm, shpresoj vitet vijuese vijmë duke u përmirësuar ende.

znj. Ernesta Krasniqi: Kërkoj sqarim, faqja 1 dhe 2 është e nënshkruar nga kryetari dhe ZKF, pastaj faqja 1 dhe 2 janë pa nënshkrim. A është gabim teknik apo çka është në pyetje?

z. Valdrin Dogani: Format i është gatshëm i MEF, që fillon nga 3-40. Unë me qëllim që me ju argumentuar juve se lënda është protokoluar dhe është dërguar në thesar., e dërgova në këtë formë. Ia kemi bashkangjitur ato dy faqe, pjesa tjetër është e konvertume në PDF që për ju me pasur pamje me të mirë, se nga skaneri nuk po janë të thënat shumë të qarta.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim me ia kaluar KK në procedurë të shqyrtimit Raportin financiar. Rezultati i votimit është njëzëri Për. Prezentë 7.

Konstatohet se KPF, Diskutoj Raporti Vjetor Financiar për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2025 dhe i njëjti i procedohet Kuvendit të komunës, në procedurë të shqyrtimit.

4. Raporti vjetor i Njësisë së Auditimit të brendshëm, për vitin 2025;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi Diskutimin. Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim për aprovim me ia kaluar KK këtë pikë. Rezultati i votimit është njëzëri Për. Prezentë 7.

Konstatohet se KPF, diskutoj Raporti vjetor i Njesisë së Auditimit të brendshëm, për vitin 2025; dhe i njëjti i procedohet Kuvendit të komunës, në procedurë të shqyrtimit.

5. Informatë për përfundimin e Gjysmëvjetorit të Parë të vitit shkollor 2025-2026;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi Diskutimin për këtë pikë:

z. Bashkim Krasniqi: Raporti është i mirë, i detajuar, ka vërejtje nga pak në mungesa dhe sukses. Shqetësuese është rënia e numrit të nxënësve për 30 nxënës me pak, krahasuar me vitin paraprak shkollor. Edhe pse Kryetari ka marrë vendim për transport falas të nxënësve, vendimi për njërën shkollë veç ka qenë me herët, mendoj se kjo dukuri ka me vazhduar, pavarësisht krijimit të kushteve, edhe pse ka cilësi në zhvillimin e mësimi, disa nxënës të fshatrave: Kaçanik i Vjetër, Begracë, Doganaj janë të prirë me vazhduar mësimin në Ferizaj. Mungesat, është mirë me u përmirësuar, por duke marrë parasysh që ka shumë ngritje kohëve të fundit, ndoshta edhe janë të arsyeshme.

znj. Kadrije Lika Troni: Desha me plotësuar Bashkimin, rënia e numrit të nxënësve, a është 30 për shkollat e mesme, se vetëm në paralelet parashkollore janë 68 me pak? Të Gjimnazi “Skënderbeu”, 224 nxënës kanë qenë të planifikuar, 155 nxënës janë. Të SHMP “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka”, 272 të planifikuar, ndërkaq janë 156 nxënës. Këto mungesa dukshme të regjistruara të nxënësve, besoj se duhet me bërë diçka që mos të shkojnë qytetarët me banuar në vende tjera. Ka nxënës që shkojnë me studiuar në shkollë të mjekësisë, por çështja e para fillorëve 68 nxënës me pak, është shqetësuese.

z. Bashkim Krasniqi: Nxënës nga disa fshatra që i potencova, kur po përfundojnë shkollën fillore, po shkojnë në Ferizaj në shkolla të mesme.

znj. Ardita Rrahmani: Është me iu falënderuar edhe drejtorit paraprak për raporte shumë të mira, se njëjtë kanë qenë raportet për 4 vite, gjë që na ka bërë me u ndier shumë mirë. Unë e di që numri i nxënësve është në rënie dhe kjo ka me vazhduar, një prej faktorëve është nataliteti i ulët, kam me diskutuar edhe në mbledhje të KK. Për mua është shqetësuese shkolla “Emin Duraku”, po e ngriti këtu dhe kam me ngritur edhe në KK çështjen e mos votimit të amendamentit për një kod të veçantë për ndërtimin e kësaj shkolle. Shkolla “Emin Duraku”, duhet me qenë prioritet i secilit, jo vetëm i neve që jemi të lidhur emocionalisht që e kemi kryer shkollën aty. Nuk lidhet kjo çështje shumë me raportin, por po kërkoj që secili nga ne këtu, me punuar sa me tepër për atë shkollë, duke lënë anash inatet politike, fushatat elektorale, se për fëmijët që mësojnë në atë shkollë, nuk është normale mos me kaluar kodi i veçantë buxhetor. Ne për fat të mirë e kemi edhe një deputet dhe kemi me i shfrytëzuar të gjitha mekanizmat për me ngritur këtë çështje edhe në ministrinë e Arsimit. Për mua prioritet ka me qenë kjo shkollë, kjo duhet me qenë prioritet edhe për ju kryetar edhe i pushtetit qendror dhe lokal.

Kryetari i Komunës-Sabedin Vishi: Pajtohem me çështjen të cilën e ngrite Ardite, kjo çështje është e kahershme, e ngriti edhe deputetja nga LDK në Kuvendin e Kosovës. E kam përcjellë se çka po parashihet me buxhet për komunën e Kaçanikut dhe çdo vendimi të mirë i duartrokas. Ju themi këtu, se jam maksimalisht me bashkëpunuar, pavarësisht a jemi të lidhur emocionalisht apo jo. Krejt këtu që jemi, i kemi objektivat e përbashkëta me përmirësuar mirëqenien e qytetarëve të komunës së Kaçanikut dhe mendoj se duhet me dhënë kontribut të përbashkët në këtë aspekt në nivel lokal dhe qendror. Unë

publikisht e themi këtu që, kurdo që jeni të gatshëm edhe me anëtarët e LVV, me shkua me trokitur nëpër dyert e ministrive të linjave të ndryshme, për çdo nevojë, aq me tepër për shkollën "Emin Duraku", vetëm e vetëm që të japim fund problemit të ndërtimit të kësaj shkolle. Është fat i mirë që ka kaluar procedurat e prokurimit shkolla "Ali Asllani", e cila është në gjendje me të mjerueshme sesa shkolla "Emin Duraku", besoj se e keni vizatuar edhe ju. Procedurat e prokurimit janë zhvilluar, janë ndarë mjetet, besoj se në shtator përfundon projekti, nëse shkojnë punët mbarë e mirë. Prandaj, ne duhet me dhanë angazhimin maksimal të gjithë, për me i dhënë fund realizimit të projektit të ndërtimit të kësaj shkolle. Ju jeni dëshmitarë të gjithë që me buxhet të komunës është e pamundur të ndërtohet. Kur është paraparë me buxhet, nuk buxhetohet vetëm kjo shkollë, por janë tre shkolla në tre shkolla, dy shkolla në Gjilan (Gjilan e Bresalc) dhe shkolla "Emin Duraku" në Kaçanik. Uroj të ndahen mjete, meqenëse ka qenë në procedurë të prokurimit kjo shkollë, por ka pasur ankesë në OSHP, të buxhetuar kanë qenë 800 mijë euro, ku i marrin a me bashkëfinancim, ata e dinë me mirë, shpresoj me u kryer njëherë e përgjithmonë kjo shkollë. Mjetet nuk janë krejt, ndërkaq në procedurë të prokurimit është shkolla "Emin Duraku", nëse nuk gabo, dy herë ka pasur ankesa. Sa i përket komunës, çdo gjë që është kërkuar, ne e kemi realizuar, si çështjen e bartjes së nxënësve në shkollën tjetër etj., çdo gjë e kemi projektuar, uroj të fillon ndërtimi i shkollës.

znj. Ardita Rrahmani: E ritheksova Kryetar, se është një temë që kemi diskutuar për 4 me së shumti. Por derisa ishte në procedurë çështja e buxhetit, mendoj se ne duhet me qenë me të zëshme në kërkesat tona. Buxheti i Republikës së Kosovës ka qenë voluminoz, diku 700 faqe, që është dashur për 2-3 ditë me shqyrtuar, secili i ka ndarë punët. Mua me kanë interesuar për projektet e Kaçanikut, ndoshta kam dalë prej teme.

znj. Ernesta Krasniqi: Keni dalë jashtë teme. Kryesues, në momentin që unë bëjë pyetje, me ndalon fjalën veç se doni ju. Ardite vazhdoni, se unë desha vetëm me u sqaruar me kryesuesin e jo me ta ndalë fjalën.

znj. Ardita Rrahmani: Jemi duke folur për çështjen e ndërtimit të shkollave. Në buxhetin e këtij viti, Ndërtimi i shkollës "Emin Duraku" nuk është në buxhet, nuk ka kaluar.

znj. Ernesta Krasniqi: Nëse ndalemi e shikojmë projektet për Kaçanik, atëherë po dalim jashtë temës.

znj. Ardita Rrahmani: Po flasim për shkollat në Kaçanik, të cilat nuk ishin në buxhet dhe për kopshtet që janë menduar me u realizuar në Kaçanik. Tani ne për 1 vit e akuzojmë nivelin lokal dhe atë qendror, se për mua nuk ka kurrfarë dallimi në momentin që nuk realizohet puna e premtuar dhe e thënë, se fjala publike ka peshë, e në këtë rast ajo peshë nuk është matur në buxhet, e kjo ndikon në jetën e secilit nga ne. Shkolla "Ali Asllani" në Doganaj, e përmenda qysh në fillim emocionalisht se unë e di që është gjendja me e keqe është në këtë shkollë, por ndoshta edhe distanca nga vendi ku unë jetoj, se unë përfaqësoj një komunitet, i cili komunitet e ka çështjen e shkollës "Emin Duraku". Padyshim që dikush që vjen nga Doganaj, me shumë të drejtë e ngrit çështjen e shkollës në Doganaj, mirëpo shkolla në Doganaj se a di unë ishte në buxhet, ndërsa "Emin Duraku" jo. Unë qysh kam qenë skeptike për 4 vite, kam me qenë edhe për 4 vite, me këtë trendë, se me 800 mijë euro një shkollë që kushton 5.6 milion euro, ndërkaq me kod buxhetor parashihet ndërtimi i 3 shkollave. Nëse ishte kryer kjo punë në 2021 ishte përfunduar me 3 milion, ndërsa me trendin e rritjes së çmimeve, pas 4 viteve bëhet 10 milion, atëherë shkolla "Emin Duraku" do të mbyllet, e nxënësit kemi me i dërguar për mësim në shkollat tjera.

Kryetari i Komunës: Unë vetëm po dua me i prirë qasjes, nga niveli lokal, se ne kur e kemi marrë pushtetin lokal, jemi të krejt qytetarëve, kështu të bëjmë punë të mira për komunën e Kaçanikut. Shumë punë varen nga niveli qendror, ndërkaq aty ku ne çalojmë, jeni këtu për me na monitoruar. I pranojmë gabimet se nuk jemi të pagabuar, ndërkaq aty ku kemi ndikim të niveli qendror, unë ju ftoj të bëjmë të mirën e përgjithshme për të gjithë qytetarët, se edhe veprat e mira ai që i bënë, i shkojnë edhe meritat.

Kryesuesi i Kuvendit: Ky është buxhet i krejt qytetarëve tonë. Ishim duke folur për shkollën, u ndërlidhë kjo çështje, pasi e kishim temë çështjen e arsimit, besoj se nuk ka gjë të keqe me fol për kushtet e shkollave et. Unë nuk foli për Kovaçec, se atje janë kushtet e mira, shkolla është e re.

znj. Kadrije Lika Troni: Nuk mundesh me fol për kushte të mira në shkollën e Kovaçecit, se ajo shkollë ka mykë.

Kryesuesi i Kuvendit: Janë përmirësuar kushtet e shkollës, por ju Kadrije nuk keni qenë në atë shkollë.

znj. Kadrije Lika Troni: Shkollat kur të ndërtohen, duhet me u ndërtuar me kualitet. Shkolla e Kovaçecit, ishte investim i madh i komunës, ndërkaq janë bërë shumë investime pas realizimit. Shkolla nuk ka pasur mbikëqyrje, ende ka mykë nëpër korridore e tualete. Nuk po foli për pjesën e arsimit, por për pjesën teknike të punës. Punët janë bërë të rangut me të dobët që ekzistojnë diku.

Kryesuesi i Kuvendit: Nuk është ashtu si po thoni. Problemet që kanë qenë në shkollën e Kovacec, janë rregulluar, si pjesa e kulmit. Është bërë një gabim, por tani janë rregulluar dhe nuk mund të themi se shkolla është keq.

znj. Kadrije Lika Troni: Edhe nëse vonohen procedurat për projekte, punët të bëhen si duhet, e mos të bëhen punë nga dy herë.

znj. Ernesta Krasniqi: Nuk bënë me kërkuar me mbledhë mjete nga fshati- fshati Nikaj. Këtë çështje e diskutojmë edhe në KK.

Kryesuesi i Kuvendit: Njerëzit vullnetmirë nuk mundemi me i ndalur. Me drejtorin e ri nuk besoj se kanë me lypur mjete me u lyer shkollat. Nuk e di nga po i merrni këto informata.

z. Kijani Zeneli: Në shkollën e Bobit nuk është që nuk është punuar, është ndërtuar edhe salla sportive, ndërkaq dëmet që janë bërë jashtë shkollë, fëmijët tanë i mbytë balta. Nuk është që nuk kemi shkollën të mira, në gjendje me të keqe janë "Emin Duraku" dhe "Ali Asllani", edhe shkollat tjera kanë nga pak nevojë me u intervenuar. Me gjerë, mund të ndërlidhem edhe në KK në këtë pikë.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë Informatën e DA e shtroj në votim me ia përcjellë KK dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Prezentë 7.

Konstatohet se KPF, **Diskutoj Informatën për përfundimin e Gjysmëvjetorit të Parë të vitit shkollor 2025-2026. Informatë për përfundimin e Gjysmëvjetorit të Parë të vitit shkollor 2025-2026;**i përcellet Kuvendit të Komunës për shqyrtim.

6. Propozim Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik Faik (Rufat) Muça;

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

z. Kijani Zeneli: Nëse ka mundësi drejtori me na dhënë sqarime të nevojshme.

z. Korab Krasniqi: Janë dy prona, e Faik Muça dhe Isen Raka, për të cilat Kuvendi i Komunës i ka shpallë me interes. Këto prona e kanë kaluar vlerësimin në ministri, tani ka mbetur pjesa e ekzekutimit. Këto prona zakonisht kufizohen me ndonjë rrugë apo pronë publike, kur ekziston interesi i komunës, atëherë ne i japim dritë jeshile me u këmbyer. Në këto raste kemi kujdes, që me u bërë këmbimet brenda zonës së njëjtë kadastrale, siç ka ndodhur edhe në këtë rast të parcela e Faikut, janë dy parcela ngjitur. Edhe nga vlerësimi i ministrisë, e kuptojmë se këto prona janë me vlefshmëri të njëjtë.

z. Kijani Zeneli: Sa është raporti i këmbimit?

z. Korab Krasniqi: Raporti është diku 1:1, sa jep komuna, aq merr. Këmbimi bëhet 63m² me 62m². Shpallja e interesit është votuar, ndërkaq këmbimi është hapi i fundit.

z. Kijani Zeneli: Këtu siç shihet janë dy prona që këmbehen me pronën e komunës, e Faikut dhe e Isenit.

z. Korab Krasniqi: Po, është prona e Faikut dhe prona e Isenit. Janë vlerësuar nga ministria në aspektin financiar, tani jemi në fazën e fundit.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë pikë e shtroj në votim me ia përcjellë KK dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Prezentë 7. Konstatohet se KPF,

Aprovoj

Propozim Vendimin për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik Faik (Rufat) Muça. Ky Propozim Vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

7. Propozim Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik Isen (Agush) Raka;

Kryesuesi i Kuvendit: Kjo është e njëjta, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

znj. Kadrije Lika Troni: Kërkoj me na sqaruar pak drejtori se cili është interesi i komunës, a kanë me u votuar në KK, pse janë kthyer këto prona me u shqyrtuar?

z. Korab Krasniqi: Këtu janë 2 parcela të cilat janë afër njëra tjetrës, materialin e keni. Prona publike për mos me ia mbyllë qasjen një prone private, pronari ka kërkuar nga komuna me i këmbyer pronat. Ne si komunë jemi me i bërë zgjidhje dhe e kemi proceduar lëndën. Lënda është trajtuar në ministri vlera e saj, është bërë vlerësimi financiar, 3,410€. Vendimin për këmbim e merr KK. Vlerësimi i pronave është i njëjtë, gjithashtu edhe vlerësimi i ligjshmërisë ka kaluar pronave.

Kryetari i Komunës: Drejtor, në KK me i pa përmes tabelave digjitale këmbimet e pronave.

z. Korab Krasniqi: Për me i pasur me të qarta se cilat prona këmbehen, në KK kanë me u prezantuar përmes tabelave digjitale.

znj. Kadrije Lika Troni: Pse janë kthyer ministria.

z. Korab Krasniqi: Ministria i vlerëson dhe i kthen, kjo është procedurë, se për këmbim duhet me u marrë vendim i veçantë.

Kryesuesi i Kuvendit: Pas kalimit të fazës së këmbimit, pronat dalin në emër të atyre që këmbehen. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim këtë pikë Rezultati i votimit, njëzëri Për.. Prezentë 7. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF,

Aprovoj

Propozim Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik Isen (Agush) Raka. Ky Propozim Vendim i Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

Kryesuesi i Kuvendit: Pika 8, është tërhequr.

z. Kijani Zeneli: Pse është tërhequr pika 8.

z. Korab Krasniqi: Është tërhequr se kemi pasur me i shpallë disa prona zonë ekonomike, kur i ka hulumtuar këto prona, e kemi vërtetuar se në vitin 2014 dhe 2016 ishin marrë vendime për ato prona me i shpallë zona ekonomike, kështu që nuk ka nevojë me marrë vendim tjetër, për pronat të cilat janë shpallë njëherë me interes.

9. Propozim Vendimi për shpallje me interes publik të parcelave kadastrale në Z.K në Kaçanik dhe në Z.K Bob;

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

z. Korab Krasniqi: Ne kemi kërkuar me u shpallë me interes disa zona, që me i paraprirë zhvillimit të atyre zonave në krijimin e infrastrukturës rrugore sipas standardeve që kërkohen. E keni pa që ne nuk marrim asnjë barrë financiare, ndërkaq nëse kërkojnë leje ndërtimore pronarët, kjo do t'iu kompensohet me bonus me etazhitet. Për t'u ekzekutuar duhet edhe një vendim i kryetarit, për derisa ata nuk kërkojnë leje ndërtimore, komuna nuk hynë në obligime. Konsideroj që është një momenti i mirë për komunën me i zgjeruar disa rrugë, rruga "Qamil Ilazi" është krijuar një kriter që ndërtimi që 7m me u larguar nga rruga kryesore, në rrugën "Ismail Qemajli" me u larguar 4 m, që në të ardhëm me u zgjeruar ato rrugë, gjithashtu krijimi i rrugës së re në f. Bob. Qasjen nëpër parcelën që tani është në qiramarrje, Castle City, për qasje me të shkurtë të Bobit në Kaçanik. Gjithashtu të parcela e dytë e Casle City, krijimin e bunarit që e ka komuna e Kaçanikut në fund të parcelës, por nuk kemi qasje. Mendoj se është një mundësi e mirë për ne si komunë me i marrë disa prona që janë strategjike për ne.

znj. Kadrije Lika Troni: Nuk e kam të qartë, ku thuhet ndërsa komuna e Kaçanikut nuk do të marrë barrë financiare, e sqaruat, ndërkaq për pjesët e propozuara me interes për komunën, do të ju epët në formë bonusi, në rast të kërimit të lejes ndërtimore në këtë parcelë. Fjala bonus a e keni marrë dikund, se kjo tingëllon ndryshe për trajtimin e qytetarëve në formë të barabartë, se dikush merr dikush jo, kjo shprehje nuk me duket se i shkon këtij arsytimi.

z. Korab Krasniqi: Ka rregullore të bonuseve, ne ende nuk kemi një rregullore të tillë, komunat tjera kanë, është në atë kuptimin e këmbimit me etazhitet.

znj. Kadrije Lika Troni: Po të kuptoj, por për derisa nuk ka rregullore, pse është shkruar këtu. Për mendimin tim kjo nuk është e ligjshme me u paraqitur kjo këtu si bonus.

z. Korab Krasniqi: Po ju kuptoj, por kjo është si praktikë e jona dhe komunave tjera, në të kundërtën nuk të jep parcelën askush, për me bërë pronë të komunës. Në momentin që e shfrytëzon bonusin, prona del në emër të komunës.

znj. Kadrije Lika Troni: Mendoj se nuk është drejtë kompensimi me bonus, se nuk keni rregullore, dhe kjo nuk është aplikuar me herët, ndërkajë kur është interesi i komunës ka të drejtë me ia kompensuar komuna, por jo me bonus.

Kryetari i Komunës: Të bonuset, nuk ka rregullore, por mundet me u aplikuar edhe pa rregullore, nëse po e marrim bulevardin "Ismail Raka", kur është ndërtuar, nëse nuk kishte me qenë tensioni i lartë, ndoshta kishin me vazhduar në atë pjesë, pa asnjë kosto financiare kishim vazhduar deri të xhamia. Asgjë nuk i pengon komunës, pos që shkon në favor të qytetarëve, ne ia kemi dhënë një etazhitet 1- 2 kate. Në mungesë të rregullores, krijohet një komision profesional, dalin i bëjnë matjet, sa merr komuna dhe sa jep.

znj. Kadrije Lika Troni: Çfarë bonusi është aty, kur dihet sa është ngushtuar rruga.

Kryesuesi i Kuvendit: Kadrije, aty shumica e pronave kanë qenë pronë private.

Kryetari i Komunës: Me rregullore të bonuseve i specifikon krejt, por në mungesë të saj, bëhet me komision të veçantë, se na e lejon ligji. Të pjesa që ka propozuar drejtori në Bob, ju e dini rruga të Çaka si është, kyçja në magjistrale është me rrezikshmëri shumë të lartë, kjo i jep qasje lagjes dhe krejt Bobit, kyçja bëhet drejt të kalaja. Për mendimin tim është mirë me shfrytëzuar kjo mundësi që e kemi.

z. Korab Krasniqi: Si praktikë është ndjekur gjithmonë, se askush nuk të fal pronën pa dhënë diçka.

z. Kijani Zeneli: Është mirë që në Kaçanik po iu jepet një dritë jeshile kompanive të ndërtimit, për me u ngjallë pak Kaçaniku, për me marrë frymë, ndërkajë forma qysh ka me qenë lejet e ndërtimit ndërtimi në të ardhmen nuk e di, ajo pjesë veç është zonë ndërtimore. Të rruga "Beteja e Kaçanikut" ku kryqëzohet me rrugën e Mulakëve, vazhdon poshtë kah fabrika, tani nuk është, rruga është me interes të veçantë të Bobit, ku është interesi i kompanisë nuk e di formën se qysh ka me u kompensuar, me ndërtim një kat apo dy. Këtu ekziston edhe një parcelë tjetër, janë mbi 24 ari, nuk e di me m², po thuhet se janë 76 ari, është pronë komunale, është bërë një gjë e mirë. Rruga për të fusha e sportit, është një rrugë që komuna na e ka shpronësuar neve, por nuk është bërë asgjë, është e mirë si rrugëdalje në Kaçanik me u lidhë me Palestrën sportive. Unë e mbështeti Propozim Vendimin, qysh kanë me u kryer punimet, e shohim kjo është rreth lumit, e kalon lumin dhe del kah fabrika ku ka qenë administrata, pjesën të cilën e merr komuna. Në parim e mbështeti, se po bëhet diçka e mirë për Kaçanikun. Kjo rrugë ka qenë e rrezikshme, ku ka pasur edhe humbje jete me herët në atë rrugë.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka, e shtoj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua njëzëri me ia kaluar Kuvendit. Konstatohet se KPF,

Aprovoj
Propozim Vendimi për shpallje me interes publik të parcelave kadastrale në Z.K në
Kaçanik dhe në Z.K Bob. Ky Propozim Vendim i
Rekomandohet
Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

10. Raporti për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara të reshurat e bores 02.10.2025 dhe të reshurat e shiut 24,25.11.2025:

10.1 Propozim Vendimi për miratimin e Raportit përfundimtar Nr. 25681/2025 dhe Nr. 26224/2025 të datës 14.11.2025 të komisionit komunal mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga reshjet e borës të datës 02.10.2025 në f.Llanishtë dhe f. Stagovë;

10.2 Propozim Vendimi për miratimin e Raportit përfundimtar Nr. 29336/2025 të datës 27.11.2025 të komisionit komunal mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga reshjet e shiut me 24 dhe 15.11.2025 në f. Bob.

Kryesuesi i Kuvendit: Të nënpika 10.1 janë 2 kërkesa, e Ramize Axhamit dhe e Hajdin Teneqja. Për sqarime të nevojshme, fjalën e ka drejtori i DBPZHR, Suhad Dullovi.

z. Suhad Dullovi: Në kuadër të pikës 10.1 janë 2 lëndë në një propozim vendim, për shkak se dëmi ka ndodhur në ditën e njëjtë, ndërkaq vlerësimi tjetër është në f. Bob, të fermeri Heset Kuka. Për shkak të mos konstituimit të KK, në takimin që e patëm takimin për kërkesën për vërshimet që kanë ndodhur fermerëve, ata na dhanë dritën e gjelbër për me i proceduar në KK. Ndërkaq të fermerët, Ramize Axhami dhe Hajdin Teneqja, dëmi ka ndodhur në të njëjtën ditë.

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Kjani Zeneli: Është mirë që janë vlerësuar dëmet. Të Heset Kuka, unë u mundova me u sqaruar me zyrtarët e drejtorisë, pse nuk iu ka vlerësuar dëmi i lakrave. Dëmi është dëm, pavarësisht afateve ligjore. Nëse mundet drejtori me na sqaruar me tepër, se nuk ka në rregull disa dëme me u vlerësuar e disa jo, mos me u ndarë fermerët sipas asaj qysh janë me të fortë. Kërkoj sqarim, pse nuk iu ka vlerësuar dëmi fermerit, Heset Kuka?

z. Suhad Dullovi: Kërkesa e Ramize Axhami, ka qenë për arra, molla e lajthia. Dëmi ju ka vlerësua për arra, jo edhe për mollë dhe lajthia, për arsye se nuk iu ka shkaktuar dëmi. Njëjtë është të Heset Kuka, kur një fermer i lënë lakrat deri në pranverë në livadh, ne nuk mundemi me i futur në sistem për kompensim.

znj. Kadrije Lika Troni: A bënë me na sqaruar për Ramize Axhami, dëmet që e theksove se ka kërkuar ti kompensohen.

z. Suhad Dullovi: Kërkesa e Ramize Axhami ka qenë për vlerësimin e dëmeve të arrave, lajthive dhe mollëve. Komisioni ka vlerësuar se nuk i janë dëmtuar mollët dhe lajthitë, ndërkaq i janë dëmtuar arrat.

z. Kjani Zeneli: Fermeri Heset Kuka, lakrat i ka produkt të vetin. Ndoshta nuk ka arritur me i shitur produktin lakër, por dëmi duhet me iu vlerësuar, jo aq sa kërkohet, por një pjesë e dëmit, se dëmin e shkaktuar nuk duhet nënvlerësuar, kur dihet se kemi raste kur i është kompensuar dëmi diku tjetër të serat, diku mbi 1,700€.

z. Suhad Dullovi: Komisioni e ka pa të arsyeshme që Heset Kuka nuk ka mundur me i shitur në kohën e duhur dhe i janë dëmtuar lakrat pas një kohe me vërshime, ne nuk mundemi me i futur në sistem për kompensim.

z. Kjani Zeneli: E debatojmë këtë çështje me gjerë në KK, me argumente shtesë.

Kryesuesi i Kuvendit: Një sqarim të pika 10.1 i kemi dy lëndë, të Ramize Axhami dhe Hajdin Teneqja, votimi shkon i përbashkët. Të 10.2 votohet veç, se vendimet bëhen veç e veç. Ne kemi mundur me i bërë krejt pika në veti.

znj. Kadrije Lika Troni: Pse nuk janë bërë pika të veçanta?

Kryesuesi i Kuvendit: Për herë tjera, pikat e kësaj natyre, me u bërë veç e veç, se edhe vendimet bëhen veç e veç dhe i dërgohen organ mbikëqyrës-MAPL.

znj. Kadrije Lika Troni: A janë këto lëndë brenda afatit kohor, për me bërë ankesa?

z. Suhad Dullovi: Po, në takimin që e patëm me drejtorin e Agjencisë së Emergjencave, janë lejuar me u proceduar tani, për arsyet që i theksova.

Kryetari i Komunës: Vendimet janë të një natyre, por mundeni edhe me i ndarë?

znj. Ernesta Krasniqi: Kërkesat janë për dëmshpërblim, por me mirë është me qenë të ndara.

Kryesuesi i Kuvendit: Mundemi me i ndarë.

z. Suhad Dullovi: Komisioni ka qenë i njëjtë për dëmin e shkaktuar në të njëjtën ditë, për atë e kemi me një vend rekomandimin.

znj. Kadrije Lika Troni: Unë jam për me i ndarë, vendimet shkojnë në ministri të Bujqësisë, çka nëse njërit i aprovohet vendimi, tjetrit jo, qysh e ndan pastaj?

z. Suhad Dullovi: Nuk besoj që ka komision që e ndryshon. E ndajmë si të doni.

Kryesuesi i Kuvendit: Drejtor, lëndën është dashur me përgatitur të veçantë për secilën. Për me ndarë nën pikën 10.1 në 2 pikë, e shtroj në votim. Rezultati i votimit është njëzëri. Për. Atëherë pika 10, ka 3 nënpika. Pikën 10 të ndarë në 3 nënpikë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Prezent 07. Konstatohet se KPF aprovoj pikën 10, me ndarje në 3 nënpika, si vijon:

1. Propozim Vendimi për miratimin e Raportit përfundimtar të komisionit mbi vlerësimin e dëmëve të shkaktuara nga reshjet e borës në Llanishtë, të fermeres Ramize Axhami;
2. Propozim Vendimi për miratimin e Raportit përfundimtar të komisionit mbi vlerësimin e dëmëve të shkaktuara nga reshjet e borës në Stagovë, të fermerit Hajdin Teneqja;
3. Propozim Vendimi për miratimin e Raportit përfundimtar të komisionit mbi vlerësimin e dëmëve të shkaktuara nga reshjet e shiut në Bob, të fermerit Heset Kuka.

Këto 3 Propozim Vendime të pikës 10, i

Rekomandohen

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, mbledhja i përfundoj punimet në ora 12: 07. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët 07.

Mbledhja e II (dytë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës e vitit 2026 e legjislaturës së 8, do të mbahet me 26.02.2026 (e enjte) në ora 11:00.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu

Malsiu



Kryesues i Kuvendit
Selajdin Troni

Selajdin Troni 12